

Superintendenti

21 Nëntor, 2023

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Ndërsa po i afrohem sezonit të Ditës Falënderimeve, doja të gjeja një moment për të shprehur mirënjohjen time të sinqertë për secilin prej jush. Angazhimi ynë për t'u bërë drejtorja arsimore urbane me përmirësim më të shpejtë në vend, me *“Accelerate Philly”*, ndërsa udhërrëfyesi ynë po bëhet realitet.

Gjatë vitit të kaluar, ne ulëm shkallën e braktisjes së studentëve nga shkolla, rritëm numrin e studentëve që kalonin provimet shtetërore, ulëm numrin e studentëve që merrnin pikët më të ulëta në nivelin bazë, dhe gjithashtu rritëm frekuentimin e studentëve dhe mësuesve. Gjithashtu, bazuar në të dhënat paraprake, ne presim që norma jonë e diplomimit katërvjeçar të rritet kur të dhënat tona të verifikohen nga Commonwealth of Pennsylvania më vonë këtë vjeshtë. Drejtorja ynë po bën përmirësime të dukshme dhe sigurisht që po shkojmë në drejtimin e duhur. Edhe pse kemi shumë punë për të bërë, kemi shumë arsye për të qenë mirënjohës.

Këtë Ditë Falënderimi, le të festojmë forcën që vjen nga përpjekjet tona kolektive dhe përparimi që kemi bërë së bashku deri tani. Me një zemër plot mirënjohje ju them faleminderit. Faleminderit për durimin, mirëkuptimin dhe besimin e vazhdueshëm ndërsa punojmë së bashku në *“Accelerate Philly”*.

Shpresoj që ju të përfitoni plotësisht për të pushuar dhe të forconi energjitë. Kaloni kohë cilësore me miqtë dhe familjen dhe kënaquni me gjërat që doni. Unë personalisht mezi pres të ulem në tryezë për atë vakt të shijshëm të Falënderimeve! Bëni çdo përpjekje për të mbajtur veten dhe familjet tuaja të sigurt dhe të shëndetshme. Ju lutemi shijoni këtë sezon festash dhe vazhdoni të bashkëpunoni me ne ndërsa ne vazhdojmë t'i përgatisim fëmijët tanë për të imagjinuar dhe realizuar çdo të ardhme që ata dëshirojnë.

Urimet më të mira për një Ditë të Falënderimeve!

Në partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Superintendenti

Drejtorja Arsimore e Filadelfias